



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 259, Datë 09.09.2026

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 15, DATË 31.01.2019,
“MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR,
TË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, E RREGJISTRUAR PRANË
QKB, SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SH.A.), TRANS ADRIATIC
PIPELINE AG”**

Në mbështetje të neneve 4, pika 50; dhe 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.09.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2507/1 prot., datë 08.09.2026, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendim nr. 15, datë 31.01.2019 “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar me vendimin e ERE-s me nr. 159, datë 31.07.2024, ka vendosur të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si Degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, për një afat 30-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.
- Në pikën 2 të vendimit nr.15/19, të ndryshuar referohet se: *Jo më vonë se data 01.07.2026, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.*
- Në kuadër të plotësimit të këtij kushti, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2507 prot., datë 13.08.2026, shoqëria ka kërkuar që ERE të konsiderojë shtyrjen për një periudhë 24-mujore të afatit të përcaktuar në kushtin e vendimit të licencimit, duke argumentuar se pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme dhe angazhimit për të përmbushur të gjitha detyrimet e licencimit, mbeten në pritje të dakortësimit dhe udhëzimeve nga autoritetet shtetërore

përgjegjëse për ta asistuar në këtë proces, në këtë rast Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

- Shoqëria argumenton se të drejtat e përfituara përmes kontratave vullnetare me pronarët privatë janë regjistruar, ndërsa të drejtat mbi tokën dhe servitutet e përfituara nëpërmjet shpronësimit, në përputhje me ligjin nr. 116/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), dhe të marrëveshjes së krahasimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)” (HGA), janë regjistruar në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfshirë edhe të drejtat mbi tokën shtetërore të dhëna në përdorim të përhershëm për TAP nëpërmjet VKM-ve.
- *Sipas HGA-së, Shtojca 1, Pjesa 2, paragrafët (h) dhe (i), këto të drejta duhet të transferohen në emër të TAP, proces i cili kërkon miratimin e VKM-ve përkatëse. Për këtë qëllim, TAP i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shkresën me referencë LT-TAPAL-ALG-01467.*
- Shoqëria ka kërkuar nga ERE që të shtyjë afatin e përmbushjes së kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15/2019, i ndryshuar, me 24 (njëzet e katër) muaj, duke argumentuar se përfundimi i procesit kërkon bashkërendimin dhe kryerjen e veprimeve nga disa autoritete shtetërore, përfshirë përgatitjen dhe miratimin e VKM-ve përkatëse dhe regjistrimin e ndryshimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, veprime këto që nuk varen drejtpërdrejt vetëm nga shoqëria. Në këto rrethana, shoqëria vlerëson se periudha 24-mujore është e nevojshme për përfundimin e procedurave të mbetura dhe plotësimin e dokumentacionit të kërkuar në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.
- Duke marrë në konsideratë se afati i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, i ndryshuar, ka përfunduar më datë 01.07.2026, por se procedurat për përmbushjen e këtij kushti vijnë të jenë në proces, si dhe se përfundimi i tyre kërkon veprime dhe bashkërendim ndërmjet shoqërisë dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse, vlerësohet e arsyeshme që, në funksion të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit, të përcaktohet një afat i ri për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar.
- Në këto rrethana, duke vlerësuar veprimet e ndërmarra nga shoqëria për përmbushjen e këtij kushti, si dhe natyrën dhe kompleksitetin e procedurave të mbetura për t’u përfunduar, Bordi vlerëson të arsyeshme kërkesën për shtyrjen me 24 (njëzet e katër) muaj të afatit, duke e përcaktuar afatin e ri deri më datë 01.07.2028.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA”, degë e shoqërisë së huaj, për shtyrjen me 24 (njëzet e katër) muaj të afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, i ndryshuar.
2. “Pika 2 ndryshon dhe bëhet:
2. “Jo më vonë se data 01.07.2028, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin kadastral të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që vërteton titujt e pronësisë mbi pasuritë përkatëse, të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licenca në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA” degë e shoqërisë së huaj dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI